



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Study program

Komunikimi Ndërkombëtar (2022/2023)

Fakulteti	Gjuhët, Kulturat dhe Komunikimi
Cikli i studimeve	Cikli i parë (Deridiplomike)
SETK	240
Kodi	IC-240
Titulli	I diplomuar në komunikimin ndërkombëtar
Numri në arkiv i akreditimit [240]	03-1776/1
Vendimi për fillim me punë	
Data akreditimit	10.06.2022

Përshkrimi i programit

Programi studimor Komunikimi Ndërkombëtar, ngërthen studime interdisiplinare dinamike dhe interaktive. Nga këto studime pritet të gjenerohen rezultate profesionale të adaptuara për nevojat e tregut global integrativ, por njëkohësisht ato do të shërbejnë si bazë për studime të nivelit postdiplomik (cikli i dytë i studimeve).

Ky program i përgatit studentët për vende pune në institucione dhe organizata ndërkombëtare, në industrinë dhe mediat, për vende pune në teknologji dhe strategji komunikuese, të cilat rriten dhe evoluojnë shpejt dhe përdoren nga korporata dhe organizata të tjera, si dhe për vende pune për marrëdhënie me publikun dhe trajnimin e zhvillimin e politikave kadrovike.

Programi mësimor për Komunikim Ndërkombëtar është dizajnuar që t'i plotësojë nevojat e tanishme dhe të ardhshme të tregut për punë në sfera të caktuara të komunikimit ndërkombëtar, në krijimin e politikave në nivel nacional dhe ndërkombëtar dhe për zhvillim korporativ në fushën e mediave, të komunikimit digjital dhe interaktiv, për zhvillim të portaleve, gazetarisë, për komunikim korporativ dhe të organizatës, si dhe të marrëdhënieve me publikun, etj. Programi studimor për Komunikim Ndërkombëtar u ofron studentëve kuptim të thellë dhe njohuri nga sfera e shkathtësive komunikuese ndërkombëtare dhe njëkohësisht i orienton në sfera të caktuara, të cilat do të specializohen në ciklin e dytë të studimeve. Përparësi plotësuese është ajo që studentët në semestrin e fundit marrin pjesë në praktika studentore, nëpërmjet të cilave kanë mundësi të përfitojnë përvojë në aspektin aplikativ të shkencave të komunikimit.

Universiteti i Evropës Juglindore posedon infrastrukturë teknologjike të jashtëzakonshme për realizim të kurrikulumit të propozuar në drejtimin e shkencave të komunikimit me laboratore kompjuterike, rrjetë interneti dhe mundësi për të mësuar në distancë, si dhe bibliotekë me online resurse të kapshme për kërkim.

Vitin e fundit studentët punojnë në projekte të mëdha individuale, ose ekipore, të cilat janë në formë të punës hulumtuese, zhvillimore, konstruktive ose praktike dhe në bashkëpunim të afërt ose nëpërmjet praktikës në kompani të vendit ose globale, institucione dhe media shoqërore-politike nacionale dhe ndërkombëtare. Kjo përvojë kultivon njohuri të zhvilluara teknike, përdorim të mendimit analitik, rezonim kuantitativ, shkathtësi për menaxhim me projekte, si dhe shkathtësi komunikuese. Prezantimi i projektit final pritet në fund të këtij programi.

Karriera

Programi i Komunikimit Ndërkombëtar është veçanërisht i përshtatshëm për ata të interesuar për punësim dhe karrierë profesionale në: organizata ndërkombëtare, diplomaci korporata shumëkombëshe, media, zyra të marrëdhënieve me publikun, organizata joqeveritare ndërkombëtare, etj.

Rezultatet e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

- Përfitim i bazës teorike, njohuri dhe kuptueshmëri e shkencave të komunikimit në përgjithësi, dhe posedim i njohurive më të thella për teoritë dhe qasjet globale nga komunikimi ndërkombëtar.
- Përfitim i njohurive hyrëse për modelet ndërkombëtare komunikuese, llojet e fushatave komunikuese dhe strategji për marrëdhënie me publikun, karakteristikat themelore të diplomacisë dhe mënyra e funksionimit të organizatave ndërkombëtare.
- Zhvillim i të menduarit kritik për komunikim ndërkombëtar.
- Të shkruarit kompetent dhe të folurit kompetent në publik dhe atmosferë private.
- Përfitim i përvojës praktike për komunikim ndërkombëtar.

Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

- Të realizojnë hulumtime dhe të jenë analitikë në sferën e komunikimit ndërkombëtar.
- Aftësi për menaxhim me programe dhe obligime të institucioneve të ndryshme ndërkombëtare, si dhe të udhëheqë trajnime dhe konsultime për shkathtësi komunikuese të aspektit nacional dhe ndërkombëtarë.
- Aftësi për menaxhim me konflikte, sjellje të vendimeve dhe zhvillim të ekipeve.
- Aftësi për mbajtje të marrëdhënieve me publikun dhe zhvillim të marrëdhënieve për publikun, marketing të fushatave në nivel vendor, nacional dhe global.
- Aftësi për analizë të publikut në nivel vendor dhe ndërkombëtar, kuptueshmëri për raportin mes shoqërisë, mediave, mesazheve, institucioneve ndërkombëtare dhe publikut.

Aftësitë për të vlerësuar

- Ndhmon në evaluimin e problemeve konkrete në lidhje me komunikimin ndërkombëtar, të cilat kanë të bëjnë me planifikim të komunikimeve, menaxhment të proceseve, kontrollit dhe menaxhment strategjik;
- Posedon aftësi që të analizojë konkurrencën mediale të tregut.
- Studentët, do të jenë të aftë të kyçen në debate në media dhe t'i argumentojnë qëndrimet e tyre, të bazohen në fakte, për tema në lidhshmëri me objektivitetin në gazetari, krijim të mendimit publik, etikën e mediave, trende moderne të marketingut bashkëkohor dhe marrëdhënie me publikun.
- Do të mund të vlerësojnë cilat janë strategjitë dhe taktikat më të përshtatshme, të cilat do të duhet të zbatohen në fushata konkrete për marrëdhënie me publikun në nivel vendor dhe global.

Aftësitë e komunikimit

- Bën prezantimin e ideve, koncepteve dhe strategjive të reja nga sfera e komunikimit ndërkombëtar.
- Njohuri të avancuara të gjuhëve të huaja për komunikimin ndërkombëtar të nivelit akademik.
- Të angazhohen në mënyrë efikase dhe konstruktive në sfera përkatëse profesionale nga komunikimi ndërkombëtar.
- Të japin prezantim të qartë dhe koherent për ndonjë temë, ose detyrë, duke përdorur shembuj dhe zgjedhje referente.
- Të përdorin burime të avancuara për përsosje dhe implementim të njohurive të përfituara.
- Të shprehen qartë dhe në mënyrë elokumente, si dhe të përfitojnë shkathtësi për të folur në publik.
- Studentët, do të marrin pjesë në krijimin e rregullave dhe karakteristikave të debateve dhe në mënyrë aktive do të debatojnë në tema që janë në lidhshmëri me komunikimin ndërkombëtar.

Aftësitë e të mësuarit

- Mund të kërkojë dhe detektojë burime për të mësuar;
- Posedon aftësi të bëjë analiza nga sfera e komunikimit ndërkombëtar dhe të përdorë literaturë shkencore dhe shqyrtime nga autorë tjerë;
- Mund të mësojë në mënyrë individuale dhe në ekip;

- Avancim i mëtutjeshëm i njohurive nëpërmjet shkathtësive për mësim interaktiv, mësim me përpilim të projekteve komunikuese praktike, të menduar kritik dhe analizë të përmbajtjeve të mediave ndërkombëtare.

Lista e lëndëve

Semestri 1

- [CCM-101] [6.0 SETK] **Hyrje në shkencat e komunikimit**
- [CCM-103] [6.0 SETK] **Hyrje në marrëdhëniet ndërkombëtare**
- [CCM-102] [6.0 SETK] **Hyrje në komunikim ndërkombëtar dhe ndërkulturor**
- [3.0 SETK] **Gjuhë shqipe/maqedonase**
- [3.0 SETK] **Gjuhë angleze**
- [6.0 SETK] **Zgjedhore/Kompetencat digjitale**

Semestri 2

- [CCM-202] [6.0 SETK] **Teoritë e komunikimit**
- [C2184] [6.0 SETK] **Komunikimi dhe teoria sociale**
- [CCM-203] [6.0 SETK] **Hyrje në shkencat politike**
- [3.0 SETK] **Gjuhë angleze**
- [6.0 SETK] **Zgjedhore/Kompetencat digjitale**
- [3.0 SETK] **Gjuhë shqipe/maqedonase**

Semestri 3

- [CCM-301] [6.0 SETK] **Metodat e hulumtimit në komunikim**
- [CCM-201] [6.0 SETK] **Studimet e mediave**
- [C2185] [6.0 SETK] **Kultura, identiteti dhe globalizmi**
- [CCM-302] [6.0 SETK] **Diplomacia**
- [C2069] [3.0 SETK] **Komunikim gojor**
- [3.0 SETK] **Gjuhë angleze**

Semestri 4

- [C2070] [3.0 SETK] **Komunikim me shkrim**
- [CCM-403] [6.0 SETK] **Organizatat ndërkombëtare**
- [CCM-402] [6.0 SETK] **Marrëdhënie me publikun: parimet dhe praktikat**
- [ECS093] [6.0 SETK] **Semiotika e komunikimit masiv**
- [C2186] [6.0 SETK] **Media dhe politika kulturore në Bashkimin Evropian**
- [3.0 SETK] **Gjuhë angleze**

Semestri 5

- [ECM-603] [6.0 SETK] **Politikat ndërkombëtare**
- [CCM-502] [6.0 SETK] **Komunikimi politik**
- [C2188] [6.0 SETK] **Zhanret mediatike dhe gazetareske**
- [6.0 SETK] **Zgjedhore nga njësi tjera**
- [6.0 SETK] **Zgjedhore e përgjithshme (nga PS)**

Semestri 6

- [C2187] [6.0 SETK] **Komunikimi global dhe ndryshimi social**
- [CCM-603] [6.0 SETK] **Komunikimi dhe lidhshipi**
- [CCM-504] [6.0 SETK] **Praktika profesionale**
- [6.0 SETK] **Zgjedhore nga njësi tjera**
- [6.0 SETK] **Zgjedhore e përgjithshme (nga PS)**

Semestri 7

- [C2189] [6.0 SETK] **Psikologjia e masmedias dhe komunikimit masiv**
- [C2190] [6.0 SETK] **Rrjetat sociale: konceptet dhe tipologjitë**
- [C2191] [6.0 SETK] **Retorika dhe fjalimi publik**
- [6.0 SETK] **Zgjedhore e përgjithshme (nga PS)**
- [6.0 SETK] **Zgjedhore profesionale (nga drejtimi)**

Semestri 8

- [C2192] [6.0 SETK] **Sociologjia e masmedias dhe komunikimit masiv**
- [C2193] [6.0 SETK] **Mediat sociale dhe komunikimet on-line**
- [CCM-802] [6.0 SETK] **Komunikimi ndërkombëtare dhe zgjidhja e konflikteve**
- [6.0 SETK] **Zgjedhore e përgjithshme (nga PS)**
- [6.0 SETK] **Zgjedhore profesionale (nga drejtimi)**

Description of courses

Lëndë obligative

- **Hyrje në shkencat e komunikimit**

Pas mbarimit të lëndës Hyrje në Shkencat e Komunikimit prej studentëve do të pritët të mund të gjenden në bisedat e thjeshta, të mund të aplikojnë dituritë për skemat e Shenanit dhe Viverit, të mund t'i tejkalojnë themelet e modeleve gjuhësore të komunikimit. Po ashtu, prej studentëve do të pritët që në mënyrë të pavarur t'i përdorin këto njohuri për nevojat e tyre të mëturshme, po njëherësh edhe si bazë për zhvillim të komunikimit.

- **Hyrje në marrëdhëniet ndërkombëtare**

Studentët njoftohen me konceptet më të rëndësishme, idetë dhe institucionet e marrëdhënieve ndërkombëtare. Lënda paraqet hulumtim të koncepteve themelore të disiplinës, me tendencë për t'i njoftuar studentët me skenën aktuale të marrëdhënieve ndërkombëtare (MN) dhe me problemet bashkëkohore ndërkombëtare, si dhe me ardhmërinë e MN, duke i diskutuar agjendat e reja. Në përfundim të lëndës studentët do të duhet të jenë në gjendje/ të përgatitur të: - zotërojnë një kuptim/ njohuri për konceptet dhe temat të disiplinës së MN; - mësojnë fuqitë udhëheqëse dhe ndodhitë, ndikimet dhe idetë që e ndërtuan evolucionin e MN; - artikulojnë dhe analizojnë temat e MN nga perspektiva të ndryshme.

- **Hyrje në komunikim ndërkombëtar dhe ndërkulturor**

Studentët, do të mund të definojnë komunikimin ndërkulturor, do të mund t'i identifikojnë dhe t'i sqarojnë politikat ndërkulturore, e ndërsa njohurinë dhe të kuptuarit do t'i aplikojnë në përpunimin e strategjive ndërkulturore me aftësi për vlerësim të identifikatorëve të identitetit të kulturave të ndryshme që ekzistojnë në RMV dhe në korniza botërore.

- **Teoritë e komunikimit**

Pas mbarimit të teorive të komunikimit, prej studentëve pritët të arrijnë njohuri të dhura dhe përparim në fushën e modeleve psikologjike të komunikimit. Përveç kësaj, prej tyre pritët të bëhen më të pavarur gjatë studimit të modeleve të njëjta dhe të marrin përgjegjësi për nxënien e tyre. Pas mbarimit të Teorisë së Komunikimit, studentët do të jenë të trajnuar të përpunojnë dhe të krijojnë shembuj nga modelet e Frojdit, teorinë e anksozitetit dhe sjelljes dhe do të jenë në gjendje të mendojnë në mënyrë kritike për tema të ndryshme dhe të sjellin vetë përfundime në bazë të teksteve të lexuara, si dhe të fitojnë aftësi për komunikim të avancuar me shkrim dhe me gojë në fushën e teorive të ndryshme psikologjike të komunikimit.

- **Komunikimi dhe teoria sociale**

Qëllimi i lëndës: Teoritë na ndihmojnë të kuptojmë botën përreth nesh. Pavarësisht nga qëllimi i tyre, të gjitha teoritë formësojnë mënyrën se si e gjejmë realitetin, marrëdhëniet, rrethanat dhe vendimet në jetën tonë. Kjo lëndë është krijuar për t'u njohur me teoritë klasike dhe aktuale që kanë të bëjnë me natyrën e ndikimit social. Do të merret një perspektivë e gjerë, duke i patur parasysh çështjet që zakonisht përfshihen në rubrikën e "bindjes", si dhe ndikimin përmes kanaleve joverbale dhe ndikimin në kontekstin e mediave masive. Teoria sociale duhet të marrë parasysh ndryshimet specifike të lidhura me internetin, pasi ato së bashku përbëjnë mënyra të reja dhe të qëndrueshme në të cilat jemi bërë objekt i mesazheve politike më të synuara dhe mënyrave për t'u angazhuar me to (politika), më të lidhur me njëri-tjetrin dhe informacionin (kultura) dhe më shumë konsum (ekonomi) online dhe të vogël, me synimin e një brumosjeje më të mirë për të kuptuar aspektet komunikuese të botës përreth. Qëllimi kryesor i lëndës është të mendosh dhe të analizosh komunikimin në mënyrë sistematike (d.m.th., në një mënyrë teorike!). Pastaj, fusha e

komunikimit studion shkencat tjera sociale dhe kupton kontributet e saj të ndryshme në njohuritë/praktikat e ndërveprimit njerëzor. Analizimi i fenomenit të komunikimit nga perspektiva të ndryshme (si pikëpamjet e përgjithshme teorike ashtu edhe teoritë specifike). Ofron njohuri dhe shpjegime mbi teoritë kryesore të komunikimit, por edhe aplikimi e njohurive të teorisë të komunikimit në çështjet e "botës reale". Kjo lëndë mundëson qasje specifike për përmirësimin e aftësive gjuhësore sociale, për të ndërtuar të kuptuarit e aftësive thelbësore të komunikimit shoqëror.

- **Hyrje në shkencat politike**

Kjo lëndë ka për qëllim t'i përgatitë studentët me bazat e shkencave politike. Do të prezantohen konceptet kryesore politike, termet, idetë dhe institucionet. Lënda është dizajnuar si një hyrje në natyrën e studimit të politikës, duke përfshirë shqyrtimin e koncepteve themelore të disiplinës: qeverinë, autoritetin, legjitimitetin. Sovraniteti, kombi, shteti, llojet e regjimeve. Në mënyrë të veçantë do të studiohen ideologjitë kryesore në teorisë politike.

- **Metodat e hulumtimit në komunikim**

Si një disiplinë shkencore e shkencave të komunikimit, lënda Metodat e Hulumtimit në Komunikim ka për qëllim t'i analizojë qasjet më të zhvilluara teorike-metodologjike në hulumtimet bashkëkohore komunikuese, si dhe sqarimin e metodave me eksperiencë (empirike) dhe teknike në shqyrtimin e dukurive komunikuese. Qëllimi është studentët të mund të sqarojnë dhe t'i dallojnë metodat kryesore cilësore dhe sasiore (mënyrat dhe procedurat) dhe teknikat kryesore (mjetet) në hulumtimet komunikuese, t'i identifikojnë dhe t'i aplikojnë fazat e veçanta në projektin komunikues dhe ta kuptojnë mënyrën e të shkruarit të raportit hulumtues. Studentët, do t'i aplikojnë njohuritë dhe të kuptuarit në përpunimin e skicës ideore për hulumtimin komunikues me të gjithë fazat e saj, e cila do të gjejë zbatim në aplikime për projekte në fusha të rëndësishme të sektorëve politikë- shoqërorë, kulturorë, profesionalë, të komunikimit masiv dhe biznesit, posaçërisht tek organizatat e sektorit civil.

- **Studimet e mediave**

Qëllimet e programit të lëndës (kompetencat), janë: - T'i përgatitë studentët në funksionet themelore të mediave dhe mjeteve për komunikim masiv, - T'i njoftojë me ndikimin e tyre dhe rëndësinë e shoqërisë, - T'i njoftojë me profesionin gazetaresk, - T'i njoftojë me funksionet dhe llojet e gazetarisë dhe prodhimeve gazetareske.

- **Kultura, identiteti dhe globalizmi**

Qëllimi i lëndës: Studentët duhet të jenë në gjendje: - Ta kuptojnë ndikimin e globalizimit në identitetin kulturor; - Të njihen me aspektet e ndryshme të identitetit kulturor (personal, etnik, social, kombëtar); - Ta shohin dhe kuptojnë në mënyrë kritike ndikimin e kulturës popullore dhe globalizimit në formimin e identitetit; - Të njihen me mënyrat e komunikimit verbal dhe jo verbal në kultura të ndryshme përmes shembujve të caktuar dhe studimeve të rasteve.

- **Diplomacia**

Lënda i njofton studentët në themelet e sqarimit teorik të themeleve të marrëdhënieve diplomatike, jep një pasqyrë të zhvillimit, të rolit dhe rëndësisë së diplomacisë në komunikimin ndërkombëtar dhe të aplikimit praktik të aftësive diplomatike në prezantimin e jashtëm të shteteve në planin politik, ekonomik dhe kulturor.

- **Komunikim gojor**

Objektivat e programit të lëndës: - T'i zhvillojnë aftësitë e komunikimit verbal. - Të jenë në gjendje të përfshihen aktivisht në një diskutim mbi një temë të veçantë. - T'i zotërojnë teknikat për komunikim të suksesshëm. - Të shprehin mendimin e tyre kritik për tema të caktuara. - T'i zbatojnë teknikat e adaptuara në karrierën e tyre profesionale.

- **Komunikim me shkrim**

Objektivat e programit të lëndës: - Të fitojë njohuri në lidhje me procesin e të shkruarit (fazat në krijimin e një teksti). - Të miratojnë normat standarde të gjuhës. - Të arrijë një nivel akademik për shprehje me shkrim në shqip, maqedonisht ose anglisht, i cili do të zbatojë njohuritë e marra më parë të gjuhës standarde. - Të inkurajojë motivimin e studentëve për shprehje me shkrim pavarësisht nga llojet dhe format e tekstit. - Të miratojë kriteret e tekstualitetit, të cilat janë thelbësore për një tekst. - Përvetësimi i aftësive për kërkimin e materialeve (biblioteka dhe burimet online).

- **Organizatrat ndërkombëtare**

Kjo lëndë fokusohet në studimin e historisë, strukturave dhe funksioneve të organizatave ndërkombëtare dhe në sistemet e brendshme komunikuese në vetë organizatat. Duke i shqyrtuar aktet e themelimit, parimet themelore të përgjegjësisë ligjore dhe funksionimit të organizatave ndërkombëtare dhe vetë shteteve anëtare të atyre

organizatave. Do të shqyrtohet mënyra dhe sistemi i komunikimit i Kombeve të Bashkuara, NATO-s, BE-së, OSBE-së, Këshillit të Evropës, etj.

- **Marrëdhënie me publikun: parimet dhe praktikat**

Njohje me parimet themelore, ligjet dhe zhvillimi i marrëdhënieve me publikun. Fitimi i njohurive për konceptin e marrëdhënieve me publikun, definicioni dhe zhvillimi historik, roli i ri i marrëdhënieve me publikun në pajtueshmëri me procesin e menaxhmentit dhe teoritë e reja për marrëdhënie me publikun.

- **Semiotika e komunikimit masiv**

Qëllimi i lëndës: Studentët të njihen me terminet semiotikë dhe komunikimin masiv.

- **Media dhe politika kulturore në Bashkimin Evropian**

Qëllimet e lëndës: Të njohë studentët me kulturën mediatike në Bashkimin Evropian, ndikimin e masmedias në formimin e vlerave evropiane, drejtimit në kritikën ndaj kulturës masive, si dhe bazat e standardeve dhe kritereve evropiane në krijimin e kulturës mediatike. Studentët, do të kenë mundësinë t'i analizojnë rregulloret evropiane dhe praktikatat kombëtare në kulturën mediatike të shteteve anëtare, si dhe të vendeve candidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

- **Politikat ndërkombëtare**

Lënda i shtjellon sistemet politike bashkëkohore, metodologjinë e hulumtimit të fenomeneve politike në planin ndërkombëtar, tipologjizimin dhe klasifikimet bashkëkohore të politikave ndërkombëtare përmes qasjes shkencore në analizën politike të strukturës, organizimit dhe funksionimit të sistemeve politike ndërkombëtare.

- **Komunikimi politik**

Nëpërmjet lëndës komunikimi politik sqarohet dhe analizohet komunikimi politik, i cili ka histori që prej kur ekziston bashkësia politike, megjithatë nuk merret me anën historike, duke dashur të mbetet me kohërat moderne dhe në aktualitetin politik. Lënda, po ashtu, ka pikë të përbashkëta me problemet e të menduarit publik, por më së shumti merret me natyrën e marrëdhënieve në mes politikanëve dhe mediave. Pas përfundimit të mësimit, studenti do të ketë mundësi të kuptojë dhe të zbatojë pikëpamjet në lidhje me krijimin politik dhe komunikimin, mënyrën e përvetësimit të ideve dhe qëndrimeve.

- **Zhanret mediatike dhe gazetareske**

Qëllimi i lëndës është të njohë studentët me llojet dhe funksionin e medias, t'i kuptojnë standardet dhe normat profesionale në punën e tyre, të aftësohen t'i dallojnë zhanret gazetareske sipas strukturës së mesazhit mediatik dhe veçanërisht e rëndësishme, për ta identifikuar ndikimin dhe efektet në audiencë, për të formuar opinionin publik dhe përcaktimet që e definojnë produktin gazetaresk, si një manipulim të opinionit publik. Për të zbatuar teorinë, studentët do të mund të dallojnë dhe shkruajnë lajmet nga komenti, gjegjësisht informativ nga zhanret analitike, duke zbatuar standarde dhe kritere profesionale.

- **Komunikimi global dhe ndryshimi social**

Lënda është krijuar për të zhvilluar aftësitë profesionale dhe një kuptim kritik të rolit të medias dhe komunikimit në lehtësimin e proceseve të ndryshimit social. Komunikimi global luan një rol kyç në sjelljen e ndryshimeve në botën përreth nesh, qoftë në lidhje me ndryshimet në normat shoqërore, zhvillimin ekonomik apo ndryshimet e gjera shoqërore që ndikojnë në politikatat publike. Kjo lëndë do të inkurajojë studentët të shqyrtojnë në mënyrë kritike teoritë e komunikimit, ndryshimet shoqërore, zhvillimin ekonomik, etj. Media dhe komunikimi i qytetarëve përfshijnë procese sociale, kulturore dhe politike që kanë potencialin të jenë transformuese. Këto qasje dhe procese, shpesh, nuk kuptohen mirë nga politika dhe praktika kryesore e zhvillimit, duke rezultuar në zbatim të dobët. Megjithatë, media dhe komunikimi i qytetarëve ka të bëjë më shumë me sjelljen e zërave të ndryshëm në politikën pluraliste, kontribuon në proceset e ndërtimit shoqëror dhe kulturor, duke ripërcaktuar normat ekskluzive dhe marrëdhëniet e pushtetit. Pjesëmarrja lokale, pronësia dhe kontrolli mund t'i lejojnë njerëzit të rikonstruktojnë hapësirat, ku zërat e tyre vijnë në shprehje.

- **Komunikimi dhe lidhshëritë**

Kjo lëndë hulumton historinë e teorive të lidhshëritë, me vëmendje primare të lidhshëritë të transformimit. Motivohet pjesëmarrja e bërjes së lidhshëritë me vëmendje të veçantë në mundësitë e komunikimit lidhshëritë i transformimit.

- **Praktika profesionale**

Qëllimi i lëndës është që studentët të fitojnë aftësi në fushën e punës praktike që t'i shtojnë mundësitë e tyre për

punësim pas diplomimit. Studentët do të mundën më lehtë t'i identifikojnë mundësitë për zhvillimin e karrierës së tyre profesionale, si dhe njohuritë për strategjitë e teknikat për kërkime në tregun e punës në rajon dhe më gjërë.

- **Psikologjia e masmedias dhe komunikimit masiv**

Qëllimet e lëndës: Studentët të njihen me ndikimet dhe rezultatet psikologjike të kërimit mediatik dhe të komunikimit masiv, si dhe rëndësinë e tyre për zhvillimin e komunikologjisë, si shkencë sociale nga njëra anë dhe nga ana tjetër, të njihen me shfaqjen e dukurive të rëndësishme shoqërore. Manipulimi dhe propaganda, bindja, përzgjedhja e fakteve dhe vlerave janë shkak dhe në të njëjtën kohë pasojë e ndikimeve negative mediatike në shoqëri, duke krijuar sindromin e identifikimit dhe projekcionit, konfliktit të sistemeve të vlerave, qytetarit të paangazhuar, privimit mediatik, ndarjes gjinore, përkatësie etnike, politike e të tjera, stigmatizimi, etj.

- **Rrjetat sociale: konceptet dhe tipologjitë**

Qëllimi i lëndës është t'i prezantojë studentët me konceptet, strategjitë dhe teknologjitë e ndryshme ekzistuese dhe të reja që përdoren në mjedisin e sotëm online. Ajo mbulon një sërë platformash të rrjeteve sociale, përmbajtje dhe mjete, si dhe çështje të sigurisë dhe privatësisë së mediave sociale. Studentët, do të mësojnë se si të përdorin mediat sociale për të arritur qëllimet personale dhe profesionale.

- **Retorika dhe fjalimi publik**

Qëllimet e lëndës: -studentët duhet të njihen me zanafillën dhe historinë e retorikës; -të dinë çfarë është retorikë e mirë; -të mësohen nga fjalimet publike të personave të suksesshëm; -të dinë se si krijohet një fjalim publik; -të prezantojnë një fjalim në ndonjë diskutim apo konferencë shkencore.

- **Sociologjia e masmedias dhe komunikimit masiv**

Qëllimi i lëndës: Siç përkufizohet nga C. Wright Mills në "The Power Elite" (1956), masmedia ka dy karakteristika të rëndësishme sociologjike: së pari, shumë pak njerëz mund të komunikojnë me një numër të madh; dhe, së dyti, publiku nuk ka mënyrë efektive për t'u përgjigjur. Komunikimi masiv është përkufizuar si një proces i njëanshëm. Kjo lëndë i fut studentët në studimin e masës dhe paraqet një ekzaminim multidisiplinar të ndërveprimit kompleks midis komunikimit masiv dhe jetës sociale. Studentët do të angazhohen në mënyrë kritike ndaj të gjitha formave të mediave masive, duke filluar nga mediat e shkruara tradicionale, radio dhe televizioni e deri tek teknologjitë e reja të informacionit. Duke përdorur një qasje historike, gjithashtu do të shqyrtojmë mënyrat në të cilat kultura dhe opinioni mund të formësohen dhe manipulohen nga burime të ndryshme mediatike. Gjithashtu, lënda shqyrton masmedian si një institucion shoqëror. Në një epokë të globalizimit, është gjithnjë e më e rëndësishme të shikosh masmedian përmes qasjeve sociologjike. Vitet e fundit, sociologët kanë studiuar ndryshime të rëndësishme në politikën publike që rregullon masmedian, përqendrimin e pronësisë mbi masmedian tradicionale dhe inovacionet teknologjike që kanë krijuar forma të reja të masmediave. Pasojat e këtyre ndryshimeve janë të mëdha. Duke përdorur libra, video, artikuj dhe projekte në klasë, do të përpiqemi t'i kuptojmë këto ndryshime dhe se si ato ndikojnë në grupe të ndryshme në shoqërinë globale.

- **Mediat sociale dhe komunikimet on-line**

Qëllimi i lëndës është të mësojë studentët se si të krijojnë dhe mbajnë një prani në media sociale për aktivitete specifike biznesi, duke përfshirë Facebook, Twitter, Google+, Tumblr, LinkedIn, YouTube, Instagram, etj. Studentët, do të mësojnë të përdorin mediat sociale për marrëdhënie me publikun dhe qëllime të tjera komunikimi.

- **Komunikimi ndërkombëtar dhe zgjidhja e konflikteve**

Komunikimi Ndërkombëtar dhe zgjidhja e konflikteve është një fushë e studimit që zgjon interesim gjithnjë e më të madh si rezultat i proceseve bashkëkohore të globalizimit. Komunikimi global i mundësuar me ndihmën e teknologjisë moderne krijon një platformë për një numër të stërmadh të komunikimeve të përditshme midis të kulturave të ndryshme. Në këtë kuptim, kjo lëndë synon të na i bëjë me dije problemet që mund ta vështirësojnë procesin e komunikimit midis kulturave të ndryshme. Tema që lidhen me problematikën e stereotipave, me përgjithësimet, shkathtësitë e komunikimit, orientimet dhe strategjitë komunikuese janë pjesë e materialit thelbësor që do trajtohet në këtë lëndë. Pritjet janë që studentët të fitojnë: - Aftësi që t'i shpjegojnë dimensionet e llojllojshme të komunikimit ndërkulturor që mund të shkaktojnë një situatë konflikti; - Të jenë të aftë ta analizojnë në mënyrë kritike dinamikën e ndërveprimit ndërkulturor; - Të jenë të gatshëm për përgatitjen dhe planifikimin e strategjisë për ndërveprimin ndërkulturor; - Të përgatisin një studim për ndonjë rast të komunikimit ndërkulturor dhe të zgjidhjes së konflikteve.

Lëndë zgjedhore

- **Gjuhë shqipe për fillestarë 1**

Lënda Gjuhë Shqipe për Fillestarë 1 dhe 2, është e përgatitur me qëllim që studentëve, të cilët nuk kanë njohuri themelore mbi gjuhën shqipe, t'u mundësojë të njihen me karakteristikat (veçoritë) e kësaj gjuhe, të fitojnë njohuri mbi strukturën gjuhësore të kësaj gjuhe, t'i zgjerojnë dhe t'i përdorin njohuritë e tyre në situata të përditshme, me ndihmën e të cilave në të njëjtën kohë, do të fitojnë njohuri mbi strukturën e gjuhës. Gjithashtu, do të jenë të aftë të fitojnë një fond modest të kategorive të ndryshme leksikore-gramatikore, të cilat do t'u mundësojnë biseda (konverzacione), të thjeshta.

- **Gjuhë shqipe për fillestarë 2**

Lënda Gjuhë Shqipe për Fillestarë 1 dhe 2, është e përgatitur me qëllim që studentëve, të cilët nuk kanë njohuri themelore mbi gjuhën shqipe, t'u mundësojë të njihen me karakteristikat (veçoritë) e kësaj gjuhe, të fitojnë njohuri mbi strukturën gjuhësore të kësaj gjuhe, t'i zgjerojnë dhe t'i përdorin njohuritë e tyre në situata të përditshme, me ndihmën e të cilave në të njëjtën kohë, do të fitojnë njohuri mbi strukturën e gjuhës. Gjithashtu, do të jenë të aftë të fitojnë një fond modest të kategorive të ndryshme leksikore-gramatikore, të cilat do t'u mundësojnë biseda (konverzacione), të thjeshta. Целта на предметот Албански јазик за почетници 1, 2 е студентите кои немаат елементарни знаења од албанскиот јазик да се запознаат со карактеристиките на овој јазик, да стекнат знаења за јазичната структура на албанскиот јазик, да ги прошират и да ги применат своите знаења во секојдневни ситуации, со помош на кои истовремено ќе стекнат знаења за јазичната структура на албанскиот јазик, ќе совладаат скроман фонд од различни лексико-граматички категории кои ќе им овозможат едноставни конверзации. Albanian Language course for beginners 1, 2 is prepared with the purpose to enable the students, who do not have basic knowledge of the Albanian language, to get to know the characteristics of this language, to gain knowledge of the linguistic structure of the Albanian language, and to extend and apply their knowledge in everyday situations. Correspondingly, they will gain knowledge of the structure of the Albanian language; They will also acquire a modest set of various lexical and grammatical categories which will enable them carry out simple conversations.

- **Gjuhë maqedonase për fillestarë 1**

Programi për Gjuhën Maqedonase për Fillestarë 1, përfshinë: të lexuarit, të shkruarit, të dëgjuarit dhe të folurit. Përmes ushtrimeve të veçanta dhe ligjëratave u mundësohet studentëve ta njohin komunikimin bazë në gjuhën maqedonase, d.m.th, të njoftuarit, përshëndetjet, prezantimin, si dhe pasurimin e fondit të fjalëve bashkë me të shkruarit dhe të kuptuarit të teksteve të vogla. Në përpilimin e programit është marrë parasysh që njohuritë e fituara nga ana e studentëve të mund të zbatohen edhe më tutje. Materiali përpunohet sipas parimit të ligjëratave dhe ushtrimeve të kombinuara, si dhe detyrave të vazhdueshme përmes, të cilave studentët përfshihen në mënyrë aktive gjatë orës mësimore duke parashtruar pyetje dhe propozime për mbarëvajtjen e orës.

- **Gjuhë maqedonase për fillestarë 2**

Lënda Gjuhë Maqedonase për Fillestarë 2, përfshinë: të lexuarit, të shkruarit, të dëgjuarit dhe të folurit. Në suaza të kësaj lënde përfshihen gjerat në vijim: detyra të përditshme, plainifikimi i aktiviteteteve për periudhën e ardhshme, përshkrimi i personave, vendeve dhe lëndëve. Në përpilimin e programit është marrë parasysh, që njohuritë e fituara nga ana e studentëve të mund të zbatohen edhe më tutje.

- **Gjuhë maqedonase niveli i mesëm 1**

Lënda Gjuhë Maqedonase - Niveli i Mesëm 1, përfshin: leximin, shkrimin, dëgjimin dhe të folurit nëpërmjet të cilit studentët: do të pasurojnë fjalorin përmes teksteve të përshtatshme për aktivitetet e përditshme (në një bankë, në bibliotekë, në ministri, etj.) dhe do të përmirësojnë shkathtësitë për shkrimin profesional dhe të folurit që janë të nevojshem për komunikim të qartë dhe efektiv në karrierën e tyre të mëtejshme profesionale. Një theks i veçantë dhe i vazhdueshëm mbi aktivitetin e përgjithshëm është vendosur në elementet gjuhësorë, domethënë në drejtshkrimin dhe gramatikën e gjuhës standarde maqedonase. Ekspertët, si një nga elementët kyç për shprehjen e mirë me shkrim e përcaktojnë përdorimin korrekt të gjuhës.

- **Gjuhë maqedonase niveli i mesëm 2**

Lënda Gjuhë Maqedonase - Niveli i Mesëm 2, përfshin: leximin, shkrimin, dëgjimin dhe të folurit. Theks i veçantë vihet në zhvillimin e aftësive të komunikimit të studentëve, ose përdorimin e gjuhës në aktivitetet e përditshme dhe kontekstin profesional, duke pasuruar fjalorin dhe duke fituar njohuri për strukturën dhe llojet e teksteve profesionale. Do të përfshihen stile të ndryshme të komunikimit, me qëllim që studentët të krijojnë komunikim të mirë me publikun përmes teksteve të tyre dhe të tërheqin dhe mbajnë vëmendjen e tyre.

- **Gjuhë maqedonase për qëllime profesionale 1**

Pas përfundimit të lëndës Gjuhë Maqedonase për Qëllime Profesionale 1, nga studentët pritet t'i zgjerojnë dhe t'i forcojnë aftësitë e tyre për shprehje më të avancuar me shkrim dhe me gojë në maqedonisht në kontekstin e

mjediseve të ndryshme profesionale. Studentët, pritet të jenë në gjendje të lexojnë, të shkruajnë dhe të kuptojnë tekste të ndryshme profesionale në maqedonisht. Ata, gjithashtu pritet të fitojnë njohuri dhe aftësi në lidhje me terminologjinë e përgjithshme nga fusha e drejtësisë, biznesit dhe ekonomisë, administratës, shkencave kompjuterike, gjuhës dhe komunikimit dhe të jenë në gjendje ta përdorin atë terminologji në korniza të profesioneve të tyre të ardhshme. Përveç përmbushjes së këtyre qëllimeve profesionale, studentët pritet të bëhen më autonomë në mësimin e gjuhës dhe të jenë në gjendje të mendojnë në mënyrë kritike në një ambient shumëgjuhësor dhe shumëkulturore.

- **Gjuhë maqedonase për qëllime profesionale 2**

Pas përfundimit të lëndës Gjuhë Maqedonase për Qëllime Profesionale 2, nga studentët pritet t'i rikonfirmojnë dhe t'i zgjerojnë më tej aftësitë e tyre për shprehje të avancuar me shkrim dhe me gojë në maqedonisht në kontekstin e profesioneve të tyre të ardhshme. Ata, do të jenë në gjendje të lexojnë, shkruajnë dhe të kuptojnë lloje të ndryshme të teksteve profesionale në maqedonisht, të analizojnë dhe t'i diskutojnë këto tekste, si dhe t'i krijojnë dokumentet e tyre, duke përfshirë biografi profesionale në maqedonisht (CV). Ata, gjithashtu duhet t'i zgjerojnë njohuritë e terminologjisë specifike nga fusha e drejtësisë, biznesit dhe ekonomisë, administratës, shkencave kompjuterike, gjuhëve dhe komunikimit dhe të jenë në gjendje ta përdorin atë terminologji në simulimin e situatave autentike nga mjediset profesionale në debate dhe në shkëmbim mendimesh në lidhje me aspektet e ndryshme të këtyre profesioneve.

- **Gjuhë angleze 1**

Pas përfundimit të secilit nivel të kësaj lënde që përcaktohet sipas testit për përcaktim të nivelit në fillim të semestrit/vitit, prej studentëve pritet të jenë në nivel të ndryshëm sipas kornizës gjuhësore Evropiane dhe të mund të kuptojnë dhe përdorin fraza dhe shprehje të ndryshme për nevojat e tyre siç janë: pyetje dhe përgjigje për veten dhe familjen, për jetën e tyre, për kohën e lirë, financat, për diploma universitare, për shkathtësi të punës, për avansimin e tyre personal, për profesionin e tyre të ardhshëm dhe të ngjashme, të marrin pjesë në dialogje dhe debate dhe të shkruajnë paragrafe apo ese për tema që i kanë përpunuar. Pas përfundimit të lëndës, prej studentëve pritet të jenë në nivelin A1 sipas kornizës gjuhësore Evropiane. Ata duhet të jenë në gjendje të kuptojnë dhe përdorin në mënyrë të drejtë shprehjet themelore në lidhje me kërkesat konkrete, të pyesin dhe përgjigjen në lidhje me pyetjet për identitetin personal dhe marrëdhëniet, të prezantojnë veten dhe të tjerët duke përdorur përemrat vetorë dhe pronorë, të përshëndeten, të përdorin fjalor të saktë për objektet në klasë, të bëjnë dallim në mes të njëjësit dhe shumësit, të njohin dhe të përdorin numrat prej 1 - 100. Gjithashtu, studentët duhet të jenë në gjendje të përshkruajnë një ditë të zakonshme me përdorim të strukturave më të thjeshta gjuhësore, të shkruajnë dhe të flasin për jetën e tyre dhe kohën e lirë. Ata duhet të njohin dhe përdorin në mënyrë të drejtë fjalorin në lidhje me kategoritë e ushqimeve dhe pijeve, muajt e vitit, të bëjnë kërkesa në mënyrë të sjellshme, të përshkruajnë vende, të zgjedhin një destinacion dhe të japin udhëzime, të flasin për gjërat që u pëlqejnë dhe nuk u pëlqejnë.

- **Gjuhë angleze 2**

По завршување на секое ниво на овој предмет кое се одредува според тест на почетокот на семестарот/годината, од студентите се очекува да бидат на различно ниво според Европската јазична рамка и да можат да разберат и користат различни фрази и изрази за нивни потреби како што се: прашања и одговори за себе и за семејството, за својот живот, за слободното време, финансии, за универзитетски дипломи, за работни вештини, за нивниот личен напредок, за својата идна професија и сл, да учествуваат во дијалози и дебати и да пишуваат параграфи или есеи на теми кои ги обработувале. По завршувањето од студентите се очекува да се на ниво A1 според Европската јазична рамка. Тие треба да се во состојба да ги разберат и употребат правилно основните изрази сврзани со конкретни барања, да прашаат и да одговорат на прашања сврзани со личен идентитет и врски, да се претстават себеси и други со употреба на лични и присвојни заменки, да се поздрават, да употребат точен вокабулар за објекти во училиница, да разликуваат помеѓу еднина и множина, да ги препознаат и да ги употребат броевите од 1-100. Исто така, студентите треба да бидат во состојба да опишат еден типичен ден и со употреба на поедноставни јазични структури да ја опишат дневната рутина, да пишуваат и да зборуваат за нивниот живот и слободно време. Тие треба да го распознаат и да го употребат правилно вокабуларот сврзан со категориите на храна и пијалоци, месеци во годината, способности и да се способни да се изразат во ситуации кога треба учтиво да побараат, да опшат места, да изберат дестинација и да дадат упатства, да зборуваат за лични преференци.

- **Gjuhë angleze 3**

Pas përfundimit të secilit nivel të kësaj lënde që përcaktohet sipas testit për përcaktim të nivelit në fillim të semestrit/vitit, prej studentëve pritet të jenë në nivel të ndryshëm sipas kornizës gjuhësore Evropiane dhe duhet të jenë në gjendje të kuptojnë dhe përdorin shprehje dhe fraza të njohura që kanë për qëllim përmbushjen e nevojave të një tipi real: të pyesin dhe tu përgjigjen pyetjeve për fenomene të ndryshme duke përfshirë krimin dhe katastrofat natyrore, të ftojnë dhe tu përgjigjen ftesave, të lexojnë dhe dëgjojnë thelbin, detajin dhe të kuptojnë, të vlerësojnë

përparimin e tyre personal, të marrin pjesë në role dhe dialogje për tema të njohura dhe të prodhojnë një paragraf/ese për temat në lidhje me temat e materialit të lëndës. Në fund të lëndës studentët pritet të jenë në nivelin B1 të kornizës së përbashkët Evropiane. Ata duhet të jenë në gjendje të pyesin pyetje dhe të përgjigjen për gradat universitare, shkathtësitë e punës dhe situatat, të ftojnë dhe tu përgjigjen ftesave. Studentët duhet të jenë në gjendje të pyesin dhe të përshkruajnë marrëdhëniet familjare dhe gjendjen martesore dhe duhet të jenë në gjendje të njohin dhe përdorin në mënyrë të përshtatshme fjalorin në lidhje me gradat universitare dhe arsimin universitar, artin, udhëtimin dhe sportin.

• Gjuhë angleze 4

Pas përfundimit të secilit nivel të kësaj lënde që përcaktohet sipas testit për përcaktim të nivelit në fillim të semestrit/vitit, prej studentëve pritet të jenë në nivel të ndryshëm sipas kornizës gjuhësore Evropiane dhe duhet të jenë në gjendje të kuptojnë dhe përdorin shprehje dhe fraza të njohura që kanë për qëllim përmbushjen e nevojave të një tipi real; të pyesin dhe të japin përgjigje për identifikim personal dhe marrëdhënie personale; të flasin dhe shkruajnë për jetën e tyre të përditshme, kohën e lirë, argëtimin, mjedisin e financave, problemet; të jenë në gjendje të pyesin pyetje dhe të përgjigjen për gradat universitare, shkathtësitë e punës dhe situatat. Pas përfundimit të lëndës studentët pritet të jenë në nivelin B2 të kornizës së përbashkët Evropiane; Ata pritet të jenë përdorues të pavarur të gjuhës angleze dhe të mundën të zbatojnë disa nga funksionet gjuhësore të mëposhtme: të japin këshilla; të pyesin pyetje dhe të përgjigjen për gradat universitare, shkathtësitë e punës dhe situatat; të ftojnë dhe tu përgjigjen ftesave, të lexojnë dhe dëgjojnë thelbin, detajin dhe të kuptojnë.

• Gjuhë angleze 5

Gjuha angleze për qëllime akademike është lëndë me kohëzgjatje prej një semestri. Qëllimet e lëndës janë t'u mundësojë studentëve të fitojnë aftësi të cilat do u ndihmojnë mësimnxënien e tyre gjuhësore dhe përparimin e tyre gjuhësor në një mjedis akademik të mësimnxënies dhe mësimdhënies. Lënda duhet ti aftësojë të përdorin këta aftësi edhe në orë të gjuhës së huaj si edhe në përparimin akademik në fushat e përmbajtjes. Ajo përfshinë aftësi gjuhësore, studiuese dhe në përgjithësi aftësi zbatuese (dëgjim, dhënie të prezantimeve me gojë, argumente konstruktive) në detyra të veçanta. Për këtë arsye, pas përfundimit të suksesshëm të lëndës, niveli i zotësisë së gjuhës duhet të jetë në nivelin C1 sipas kornizës së përbashkët Evropiane. Si rezultat, studentët duhet të jenë në gjendje të prezantojnë në mënyrë të suksesshme prezantime orale, të marrin pjesë në tribuna të debateve/diskutimeve online duke shprehur mendimet dhe argumentet e tyre dhe tu japin të tjerëve informacion kthyes në mënyrë konstruktive. Përveç kësaj, studentët duhet të jenë në gjendje të dëgjojnë dhe lexojnë thelbin dhe të shkruajnë një paragraf dhe ese argumentues duke shprehur mendimet e tyre. Ata duhet të shkruajnë një paragraf dhe ese që zgjidh problemin. Ata duhet të jenë në gjendje të prezantojnë informacion pamor në formën e prezantimit poster në Power Point. Studentët duhet të jenë në gjendje të identifikojnë idetë kryesore dhe faktet mbështetëse në një tekst dhe të analizojnë dhe identifikojnë fjalinë kryesore të temës në një paragraf. Ata duhet të jenë në gjendje të identifikojnë qëllimin e një teksti, modelet e organizimit në një tekst dhe të zbatojnë ata në shkrimet e tyre.

• Anglishtja për shkenca shoqërore 1

Kjo lëndë ofrohet me qëllim të përmirësimit të katër aftësive kryesore të gjuhës, siç janë leximi, shkrimi, dëgjimi dhe të folurit në fushën specifike të përmbajtjes, si dhe rishikimi dhe avancimi i artikujve dhe fjalorit të përzgjedhur në nivel të mesëm dhe të mesëm të lartë në fushën e shkencave shoqërore. Kjo është bërë për t'u mundësuar studentëve të kuptojnë tekste më të komplikuar në fushën e përmendur dhe t'u mundësojnë atyre të komunikojnë me rrjedhshmëri me kolegë dhe ekspertë në fushën e shkencave shoqërore. Kjo lëndë fokusohet në zhvillimin e njohurive gjuhësore në fjalorin e përgjithshëm dhe në lëndët, zhvillimin e aftësive akademike të shkrimit dhe leximit dhe diskutimin e artikujve nga fushat e Politikës Publike, Shkencave Politike dhe Komunikimit Ndërkombëtar, si pjesë e aftësive të tyre të të folurit. Fokusi kryesor është përdorimi i fjalorit profesional të lidhur me komunikimin dhe zhvillimin e karrierës së ardhshme të studentëve.

• Anglishtja për shkenca shoqërore 2

Kjo lëndë ofrohet me qëllim të përmirësimit të katër aftësive kryesore të gjuhës, siç janë leximi, shkrimi, dëgjimi dhe të folurit në fushën specifike të përmbajtjes, si dhe rishikimi dhe avancimi i artikujve dhe fjalorit të përzgjedhur në nivel të mesëm dhe të mesëm të lartë në fushën e shkencave shoqërore. Kjo është bërë për t'u mundësuar studentëve të kuptojnë tekste më të komplikuar në fushën e përmendur dhe t'u mundësojnë atyre të komunikojnë me rrjedhshmëri me kolegë dhe ekspertë në fushën e shkencave shoqërore. Kjo lëndë fokusohet në zhvillimin e njohurive gjuhësore në fjalorin e përgjithshëm dhe në lëndët, zhvillimin e aftësive akademike të shkrimit dhe leximit dhe diskutimin e artikujve nga fushat e Politikës Publike, Shkencave Politike dhe Komunikimit Ndërkombëtar, si pjesë e aftësive të tyre të të folurit. Fokusi kryesor është përdorimi i fjalorit profesional të lidhur me komunikimin dhe zhvillimin e karrierës së ardhshme të studentëve.

• Kapituj të zgjedhur nga shkathtësitë e TI

Qëllimi i kësaj lënde është: - T'ua tregojë studentëve elementet teknike, strukturën e tekstit dhe dizajnin e punimeve të ndryshme gjatë studimeve. - T'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri mbi shkathtësitë e TI, që do t'u duhen për përpunimin e punimeve shkencore, profesionale dhe prezantime. - Të aftësojë studentët për zbatimin praktik të shkathtësive të TI.

- **Microsoft Office Access**

Kursi Zyrtar Akademik i Microsoft (MOAC) për Aksesin 2016, ofron përvojën praktike për të rritur aftësitë tuaja personale të produktivitetit. Ky program, i ndarë në 15 mësimë, mbulon të gjitha fushat e produktit që kërkohet për të kaluar provimin MOS 77-730.

- **Microsoft Office Excel**

Kursi Zyrtar Akademik i Microsoft (MOAC) për Excel 2016, ofron përvojën praktike për të rritur aftësitë tuaja personale të produktivitetit. Ky program, i ndarë në 13 mësimë, mbulon të gjitha fushat e produktit që kërkohet për të kaluar provimin MOS 77-727

- **Microsoft Office PowerPoint**

Kursi Zyrtar Akademik i Microsoft (MOAC) për PowerPoint 2016, ofron përvojën praktike për të rritur aftësitë tuaja personale të produktivitetit. Ky program, është i ndarë në 11 burime mësimore dhe mbulon të gjitha fushat e produktit të kërkuara për të kaluar provimin MOS 77-729.

- **Microsoft Office Word**

Kursi Zyrtar Akademik i Microsoft (MOAC) për Word 2016, ofron përvojën praktike për të rritur aftësitë tuaja personale të produktivitetit. Ky program është i ndarë në 11 burime mësimore dhe mbulon të gjitha fushat e produktit të kërkuara për të kaluar provimin MOS 77-725.

- **Krijimi i ueb-it**

Qëllimi i lëndës është zhvillimi i një ueb faqe të thjeshtë bazuar në standardet aktuale. Kerkon njohuri të gjuhës Hypertext Markup Language (HTML) dhe Cascading Style Sheets (CSS). Shumica e ueb faqeve përdorin imazhe në formë të banerave, logove, imazheve, ose skanimeve. Adobe Fireworks është ndërtuar si një mjet për të krijuar dhe manipuluar imazhet e dizajnuara për ueb dhe për të lejuar krijuesit të zgjedhin këto imazhe në mënyrë që të zvogëlojnë madhësinë e skedarit. Fireworks gjithashtu mundëson integrim të shkëlqyer me Dreamweaver. Kjo lëndë ofron një seri aktivitete që mundësojnë një hyrje gjithëpërfshirëse në HTML, CSS dhe krijimin e imazheve për ueb.

- **Dizajnimi i medimeve digjitale**

Qëllimi i lëndës është të dizajnojë dhe përpunojë grafika raster dhe vektoriale përmes programeve kryesore, siç janë Adobe Photoshop dhe Illustrator, si dhe projektimin dhe botimin e materialeve komerciale për shtyp, duke përdorur Adobe In Design

- **Google aplikacione për edukim**

Përmbledhje konceptuale me udhëzime praktike për shfrytëzimin e potencialit arsimor të G Suite. Kjo i identifikon parimet e të mësuarit që e mundësojnë përdorimin efektiv të G Suite për të krijuar mjedise mësimore që rrisin komunikimin arsimor. Lënda është e organizuar në një seri modulesh. Modulet janë të bashkangjitur në një meni përmbledhëse, të cilat mund të qasen në faqen "Google" për edukim, e cila i organizon modulet me po të njëjtën radhitje me të cilën do të diskutohen në klasë.

- **Hyrje në administrimin publik**

Administrata publike paraqet një fushë të veçantë me interes shkencor. Lënda: Hyrje në Administrimin Publik duhet t'u ofrojë studentëve njohuri mbi konceptet themelore të administratës publike. Kujdes i posaçëm do t'i kushtohet ofrimit të njohurive për evoluimin e administratës publike, si dhe të reformave të parapara të administratës publike në vendin tonë. Gjithashtu, studentët do të kenë mundësi të njoftohen dhe në mënyrë kritike ta analizojnë zhvillimin dhe fenomenet në administratën publike. Meqë lëmi i studimit është objekt i ndryshimit të pandërprerë, kujdes i veçantë do t'u kushtohet zhvillimeve të reja si dhe teorive klasike të studimit të administratës publike. Materia hulumtuese e kësaj lënde konsiston në: përkufizimet dhe njohuritë themelore për parimet dhe institucionet e administratës publike, rolin dhe rëndësinë e administratës publike në shoqërinë e organizuar, gjenezën dhe zhvillimin historik të administratës publike, strukturat organizative të administratës publike, funksionimin e institucioneve të administratës publike, shërbimet e administratës publike, vendimarrjen në AP.

- **Lidershipi publik dhe zhvillimi organizativ**

Kjo lëndë ka për qëllim t'i njoftojë studentët me mënyrën se si liderët dhe udhëheqësit i zhvillojnë dhe si i zbatojnë arritjet e misionit dhe vizionit në një organizatë të dhënë në sektorin publik; zhvillimin e vlerave të nevojshme për sukses afatgjatë dhe zbatimin e tyre nëpërmjet aktiviteteve dhe shprehive të përshtatshme; si liderët dhe udhëheqësit janë personalisht të përfshirë në sigurimin, që sistemet e menaxhimit të sigurisë, do të zhvillohen dhe zbatohen. Gjithashtu, i njofton për mënyrën se si organizata e realizon misionin dhe vizionin e saj përmes një strategjie të qartë të bazuar në pikëpamjet e të gjitha palëve të interesuara, të mbështetur nga të gjitha politikat relevante, planet, qëllimet dhe proceset.

- **Hyrje në politikat publike**

Lënda ka për qëllim t'u mundësojë studentëve që t'i kuptojnë më lehtë politikat publike, parimet për krijimin e tyre, udhëheqjen e një politike konkrete, analizën, implementimin, vlerësimin dhe zhvillimin e saj. Menaxhimi i politikave publike është disiplinë për zgjidhjen e problemeve të cilat rezultojnë në njohuri nga metodologjitë dhe teoritë themelore të shkencave sociale, të profesioneve sociale dhe të filozofisë së politikave.

- **Liritë dhe të drejtat e njeriut**

Lufta për të drejtat e njeriut fillon me përpjekjet historike për t'i identifikuar ato. Me kalimin e kohës, korpusi i të drejtave dhe lirive të njeriut që mbrohen me ligje dhe marrëveshje ndërkombëtare është zgjeruar, por kjo nuk do të thotë se ato respektohen në praktikë. Në fillim, të drejtat e njeriut konsideroheshin si çështje të brendshme të shteteve (sipas parimit të sovranitetit absolut të shtetit) dhe vetëm në kohërat më të reja ato fituan statusin e normave kogente. Kjo lëndë e studion zhvillimin e doktrinë për të drejtat e njeriut, llojet dhe kategoritë e të drejtave të njeriut dhe dokumentet kryesore që i rregullojnë dhe që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut. Kjo lëndë ka për qëllim: t'i njoftojë studentët me konceptin e të drejtave ndërkombëtare të njeriut, me zbatimin e tyre dhe me ndikimin që ato kanë në formulimin e politikave kombëtare. Kjo do t'i inkurajojë studentët të reflektojnë në mënyrë kritike mbi raportin mes të drejtës ndërkombëtare dhe të asaj kombëtare, do t'i vetëdijësojë ata për ndryshimet ndërkombëtare në këtë drejtim dhe për mënyrën se si këto të drejta ndikojnë në jetën e njerëzve në botë. Lënda do t'i nxisë që të kontribuojnë në përparimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

- **Shkrimi dhe arsyetimi ligjor**

Qëllimi i lëndës është që të ofrojë njohuritë themelore të shkrimit dhe arsyetimit juridik studentëve të vitit të parë. Në këtë lëndë, do të përfitohen njohuritë e shkrimit dhe arsyetimit juridik, parimet dhe udhëzimet themelore për të, duke zbatuar metodat e ndryshme të shkrimit juridik të akteve juridike normative (rregulloret, ligjet, vendimet, aktgjykimet, kontratat, testamentet, etj) dhe të akteve juridike jonormative (CV, kërkesa, konkursi, aplikimi, njoftimi, padia, etj).

- **Teknologjia riprodutive e asistuar dhe e drejta**

Kjo lëndë ka për qëllim të theksoj faktin se në shoqërinë bashkëkohore, tanimë nuk ekziston një model universal i familjes dhe prindërisë. Me studimin e lëndës 'Teknologjia Reprodutive e Asistuar dhe e Drejta', studentët do të fitojnë njohuri rreth teknologjive të reja për riprodhimin artificial, të cilët janë pjesë e politikës bashkëkohore të natalitetit. Studentët, në detaje do të mësojnë për të gjitha metodat e reja të riprodhimit të qenies njerëzore, duke përfshirë: inseminimin artificial, in-vitro fertilizimi, amësia surrogate, lindja e fëmijës nga një grua me spermë të donuar, riprodhimi post human, ko-prindëria (bashkëprindëria), ngjizja e fëmijës nga tre persona, krioprezervimi i gameteve ose embrioneve. Nëpërmjet kësaj lënde, studentët do të njoftohen se ekzistojnë edhe forma tjera, të cilat shkenca i ofron, por ende konsiderohen procese të ndaluara: klonimi, zgjedhja e gjinisë së fëmijës, përmirësimi i kapaciteteve fizike, intelektuale të fëmijës së ardhshëm (eugenika), etj. Përmes studimit të kësaj lënde, pritët nga studentët, që ta zhvillojnë mendimin e tyre kritik me anë të debateve për dilemat e shumta morale, etike dhe juridike lidhur me këto teknologji të reja për riprodhimin e qenies njerëzore.

- **Dhuna në familje**

Dhuna në familje është një fenomen shoqëror me përmasa dhe shtrirje të gjerë edhe në shoqërinë bashkëkohore. Ajo, është e pranishme në të gjitha shtetet e shoqëritë, pavarësisht zhvillimit dhe emancipimit të tyre. Imunë ndaj këtij fenomeni nuk është as vendi ynë e as rajoni në të cilin jetojmë. Andaj, studentët e drejtësisë përmes kësaj lënde fitojnë njohuri rreth asaj se çfarë është dhuna në familje, format në të cilat ajo manifestohet, rregullimet ligjore në vend, rajon dhe në sferën ndërkombëtare, si dhe mënyrat e parandalimit të saj. Përmes kësaj lënde, studentët në fund të lëndës, do të jenë në gjendje ta identifikojnë dhunën në familje, t'i identifikojnë veprat penale që inkriminohen në Kodin Penal si dhunë në familje, si dhe të zhvillojnë mendim kritik rreth kësaj problematike. Kjo lëndë e aftëson juristin e ardhshëm që gjatë ushtrimit të profesionit të tij si gjykatës, prokuror apo avokat t'i trajtojë në mënyrë sa më adekuate çështjet nga kjo sferë që kanë ndjeshmëri të lartë, si dhe të ofrojnë ndihmë dhe mbrojtje sa më adekuate për viktimat e këtyre veprave penale.

- **Hyrje në shkenca kompjuterike**

Kjo lëndë paraqet një hyrje të gjerë dhe të integruar në konceptet themelore të shkencave kompjuterike. Lënda mbulon tema, siç janë: historia e llogaritjes; logjika dhe sistemet digjitale; hyrje në arkitekturën kompjuterike, algoritme të thjeshta, zgjidhje problemesh dhe struktura të dhënave; hyrje në gjuhët e programimit, sistemet operative, bazat e të dhënave, rrjetat, inxhinieria e softuerit dhe ueb-it; llojet e aplikacioneve, përfshirë edhe përshkrimin e disa programeve specifike (procesorë teksti, baza të dhënash, shfletues, etj.); procedimi i të dhënave tradicionale dhe multimediale.

- **Teknologjitë e Internetit**

Qëllimi kryesor i lëndës është që t'u jep studentëve njohuri praktike mbi mekanizmat themelorë, shërbimet dhe protokollet e rrjetit global - Internetit. Lënda ofron mësimin e arkitekturës së përgjithshme të uebfaqeve efikase, skalabile dhe të sigurta. Studentët, do të fitojnë njohuri të thella teknike të XML, XHTML (listat, tabelat, figurat, multimedia dhe formularët), CSS (formatimi, stilet dhe layout-i), si dhe JavaScript (variablat, kushtet, ciklet dhe funksionet).

- **Probabiliteti dhe statistika e zbatuar**

Qëllimi i kësaj lënde është t'i pajisë studentët me njohuritë themelore nga probabiliteti dhe statistika që kanë zbatim të drejtpërdrejtë në fushën e shkencave kompjuterike. Qëllimi është që të mësohet se si bëhet përpunimi i të dhënave statistikore, ligjshmëritë e tyre, paraqitja e tyre, ligjet për dhënien e konkluzioneve përkatëse bazuar në të dhënat e përpunuara, etj. Po ashtu, qëllimi është që të mësohen parimet themelore nga fusha e probabilitetit dhe se si mund të zbatohen ato parime në fushat e ndryshme nga jeta e përditshme posaçërisht në lëmin e shkencave kompjuterike.

- **E-tregtia**

Lënda ka për qëllim t'i mësojë studentët me konceptet themelore dhe me terminologjinë e e-tregtisë (e-commerce): ● historinë e e-tregtisë ● e-botën: e-biznesin dhe e-tregtinë ● modelet e biznesit për e-tregtinë ● sistemet e pagesave online ● marketingun online ● e-infrastrukturat. - T'u mësojë teknologjitë kryesore, të cilat janë të detyrueshme për të drejtuar e-tregtinë në ditët e sotme, duke përfshirë: shërbyesit (serverët), aplikacionet (software), lidhjet e internetit, portat e pagesës dhe sigurinë e tyre, "cookies", etj. - Të bëhet aplikimi i konceptit "e-commerce" nga teoria në praktikë, duke bërë analizë të duhur në modelet e biznesit dhe teknologjive, si dhe marrjen e vendimeve në zgjidhjet më të përshtatshme. - Të sqarohet kuptimi i procesit të krijimit të një dyqani ueb dhe lidhja e tij me sistemet e pagesës (porta pagese / payment gateway). - Studenti të jetë në gjendje ta aplikojë këtë ide të e-biznesit në letër, të krijojë modelin e biznesit dhe të përgatisë financat. - Studenti të jetë në gjendje t'i dallojë mjetet e ndryshme në internet për marketing dhe të jetë në gjendje të zbatojnë disa prej tyre në praktikë. - Shqyrtimi mbi sigurinë e informacionit, etika dhe çështjet sociale si dhe mënyrat për të trajtuar çështje të veçanta. - Studenti të jetë i njohur me internet dhe "cloud" shërbimet.

- **Hyrje në sistemet e informacionit**

Qëllimet e kësaj lënde janë: Të mësohen konceptet themelore dhe terminologjia e sistemeve të informacionit: - Konceptet themelore të sistemeve të informacionit: hardueri, softuerie, rrjetet; - E-World: e-biznes dhe e-commerce; - Zhvillimi i proceseve; Të mësohen sistemet e informacionit dhe të teknologjive që përmirësojnë vlerat e biznesit dhe proceset e ndryshme brenda organizatave; Aplikimi i IS koncepteve në disiplina të ndryshme drejtuese, gjatë analizës, interpretimit, vlerësimit dhe vendimeve; Kuptimi i procesit të ridizajnit të organizatave duke përdorur sistemet e informacionit; Përshkrimi i rolit të sistemeve të informacionit në vendimmarrje; Shqyrtimi i sigurisë së informacionit, etikës dhe çështjeve sociale; Njoftimi me internetin, tregtinë elektronike dhe e-biznesin; Përgatitja e studenteve për të punuar në projekte të vogla, puna individuale apo grupe, të cilët nga natyra mund të bien në këto kategori: studimet e rastit, projektit kërkimor shkencor, projekte zhvillimore ose projekte praktike.

- **Etika profesionale e TI**

Lënda siguron qasje gjithpërfshirëse në çështjet aktuale etike me rastin e shfrytëzimit të teknologjive të informacionit (TI). Vlerëson një sërë çështjesh të shtrura në vitet e kaluara dhe ato të tanishmet me të cilat ballafaqohen shfrytëzuesit e TI-së, duke filluar nga liria e të shprehurit, privatësia, pronësia intelektuale, hakerimi, dhe vazhdon me epokën e re, shfrytëzimin etik të rrjetave sociale dhe komunitetet online. Trajtohen dilemat etike dhe përgjegjësitë etike të profesionistëve të TI-së, si dhe promovohet vlerësimi kritik dhe shfrytëzimi i përgjegjshëm i TI-së.

- **Gjuhë shqipe me kulturë shkrimi**

Lënda Gjuhë Shqipe me Kulturë Shkrimi është një sintezë e rregullave dhe udhëzimeve, të cilat janë të parapara për t'i përmirësuar shkathtësitë e të shprehurit me shkrim dhe me gojë në gjuhën shqipe. Përmirësimi i këtyre shkathtësive, para së gjithash, parashihet që të realizohet përmes familjarizimit me rregullat drejtshkrimore dhe disa norma morfologjike e sintaksore të gjuhës shqipe që shihen si të nevojshme që të arrihet përdorimi i drejtë i gjuhës. Më pas, theks i veçantë i kushtohet motivimit të studentëve për ligjërim të rrjedhshëm, rritjes së vetëdijes për përdorimin e gjuhës së pastër dhe standarde shqipe. Gjithashtu, hapësirë të veçantë zë edhe nxitja e vullnetit për

përmirësim të procesit të të shkruarit, duke i vetëdijësuar studentët për dallimet e llojeve të teksteve të shkruara, por edhe për vetëdijen për integritet akademik në punimet serioze kërkimore (plagjiaturën), duke mos lënë pas as përfshirjen e terminologjisë specifike të fushave të ndryshme në të cilat janë të orientuara studentët. Të gjitha këto tema janë paraparë që studentëve t'u ofrohen si njësi mësimore të kombinuara, gjegjësisht si rregulla, udhëzime e ushtrime që plotësohen mes veti.

- **Gjuhë gjermane 1-4**

Me përfundimin e lëndës, nga studentët pritet që të kenë fituar njohuri të duhura në përputhje me Kornizën Evropiane të Gjuhëve (të përcaktuara saktësisht në nivele). Përveç kësaj, pritet që studentët të bëhen më të pavarur dhe më të përgjegjshëm ndaj mësimi të gjuhës. Deri në fund të lëndës, studentët do të jenë në gjendje që në mënyrë kritike të reflektojnë mbi tema të ndryshme dhe të japin përfundime. Studentët, gjithashtu do të jenë në gjendje t'i shprehin mendimet dhe opinionet e tyre në formë të shkruar dhe gojarisht në gjuhën gjermane.

- **Multikulturalizmi në mësimdhënien e gjuhës angleze**

Qëllimet e programit të lëndës: Aftësi komunikimi: Studentët pritet të jenë në gjendje të prezantojnë opinionet e tyre në lidhje me kulturën dhe globalizimit dhe e gjithë kjo reflektohet në procesin e arsimimit. Pritet të diskutohen tema lidhur me tolerancën, mirëkuptimin, dhe akomodimin e diversitetit. Ata, gjithashtu, do të punojnë drejt përgatitjes të eseve, ku do të trajtohen çështjet e relativizmit kulturor, stereotipeve, paragjytimeve, si dhe zhvillimi i koncepteve të bashkëpunimit ndërkulturor dhe arsimimit multikulturor. Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit: Krijimi i modeleve arsimore për bashkëpunim multikulturor dhe zbatimi i tyre në procesin e mësimdhënies së gjuhës angleze si gjuhë e dytë. Zhvillimi i një strategjie arsimore që do të tregohet e suksesshme në situata ku mund të ketë tensione në mesin e studentëve për shkak të mungesës së tolerancës. Aftësitë për të vlerësuar: Përpunimi i portofolit individual të bazuar në parimet e arsimimit multikulturor dhe kapacitetit, si dhe identifikimi i rasteve kur ka mungesë tolerance, duke synuar zhvillimin e frymës së bashkëpunimit ndërkulturor. Njohuri dhe mirëkuptim: Njoftim me parimet themelore të kulturës, relativizmit kulturor, arsimimit ndërkulturor dhe multikulturor dhe adresimi i këtyre çështjeve në kuadrin e mësimdhënies së gjuhës angleze si gjuhë e huaj. Aftësitë e të mësuarit: Njoftim me modelet efikase për promovimin e multikulturalizmit në procesin arsimor, ku gjuha angleze do ta ketë rolin më të rëndësishëm, si gjuhë neutrale për studentët, pavarësisht nga përkatësia etnike.

- **Studime ndërkulturore**

Pasi ta kenë përfunduar lëndën, studentët, do të mund t'i identifikojnë çështjet globale dhe problemet nga perspektiva e kulturave të ndryshme, dinamikën e komunikimit në kulturat tjera, ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet vlerave të tyre dhe ato të kulturave tjera, si dhe ngjashmëritë dhe dallimet e praktikave të komunikimit të tyre dhe të kulturave tjera. Aq më shumë, nga studentët pritet që të bëhen më të vetëdijshëm për stereotipat që shoqëria i ka për kulturat e ndryshme dhe, si pasojë, më mirë do ta kuptojnë vendin e tyre në komunitetin global. Studentët, do të fillojnë të mendojnë në mënyrë kritike mbi tema rreth etnisë së tyre, identitetin gjinor, klasën, fenë, origjinën kombëtare, moshën si dhe karakteristika të tjera demografike dhe ndikimin e tyre në procesin e komunikimit. Pas përfundimit të lëndës studentët do të fitojnë aftësi të komunikuarit të nevojshme për punën në grupe përmes pjesëmarrjes së tyre në hulumtime dhe gjithashtu do të fitojnë aftësi për t'i prezantuar këto projekte kërkimore.

- **Arsyetimi dhe mendimi kritik**

Pas përfundimit të suksesshëm të lëndës, studentët, do të jenë në gjendje që ta përmirësojnë mënyrën e tyre të menduarit, përmes të kuptuarit të strukturave të brendshme të procesit të menduarit dhe duke i rishikuar ato në kuadër të standardeve individuale dhe akademike. Ata, do të zhvillojnë strategji të vendimmarrjes, të bazuara në reflektim, arsye dhe logjikë. Përmes kësaj lënde, studentët, do të mësojnë se në bazë të cilave tendenca, ngjashmëri dhe supozime bazohen reflektimet e tyre, si dhe cilat kushte dhe pasoja lindin nga mënyra e tyre e menduarit. Ky mendim reflektues, nënkupton një rishikim aktiv, të kujdesshëm dhe të vazhdueshëm të të gjitha besimeve individuale në lidhje me fundamentin që i mbështesin ato dhe konkluzionet që dalin prej tyre. Studentët pritet të fitojnë njohuri dhe aftësi për të marrë vendime të kapshme, të nevojshme në mjedisin e përditshëm në lidhje me profesionet e tyre të ardhshme.

- **Marrëdhëniet me publikun dhe mediat e reja**

Lënda, do të fokusohet në zhvillimin e aftësive komunikuese dhe të teknikave që janë të domosdoshme për funksionimin efektiv në epokën e globalizimit. Studentët, do ta përpunojnë procesin e globalizimit, aspektet sociale, aspektet politike, ekonomike dhe kulturore të fenomenit modern, si dhe pasojat dhe ndikimet në sferën e komunikimit, të cilat njëherësh karakterizuan edhe një epokë të postmodernizmit, veçanërisht ndikimin e mediave të reja sociale, strukturën dhe funksionin e tyre, multilingualizmin në rrjetet sociale, efektet dhe pasojat në realitetet moderne të komunikimit në botë.

- **Media dhe shoqëria**

Mediat dhe Shoqëria paraqet hyrje të studentëve në një disiplinë, e cila i studion marrëdhëniet komplekse mes mediave dhe shoqërisë, rolin e mas mediave si teknologji ndërmjetësuese gjatë komunikimit masiv dhe global. Qëllimi i veçantë i lëndës janë implikimet politike, sociale dhe kulturore të mediave mbi shoqërinë.

- **Hyrje në ekonomi dhe biznes**

Qëllimi kryesor i kësaj lënde është ta zhvillojë kuptimin bazik të koncepteve dhe teorive kryesore ekonomike, të cilat përdoren për analizë të çështjeve ekonomike. Kjo lëndë është e dizajnuar në atë formë që t'u mundësojë studentëve të pajisen me njohuri për parimet bazë, me konceptet dhe teknikat në fushën e ekonomisë si shkencë, si dhe në analizat ekonomike. Kjo lëndë siguron hulumtimin e parimeve të mikroekonomisë dhe makroekonomisë, duke u fokusuar në implementimin e dijes në sjelljen e vendimeve në një ambient global. Pas mbarimit të lëndës, studentët duhet të aftësohen: ta përdorin modelin e ofertës dhe kërkesës dhe ta përcaktojnë ndikimin e ndryshimeve të kërkesës dhe ofertës mbi çmimin dhe sasinë; ta definojnë PBB (GDP) dhe të kalkulojnë matjen, përdorimin dhe kufizimin e PBB (GDP), si një mjet i mirëqenies ekonomike; ta definojnë inflacionin dhe ta kalkulojnë atë, të njihen me pasojat dhe si të përshtaten në to; si dhe t'i përshkruajnë rolet dhe mjetet e bankës qendrore.

- **Parimet e menaxhmentit**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët që njoftohen me bazat e menaxhmentit, gjenezën dhe përkufizimin e tij, si dhe me parimet themelore në të cilat do të bazohet puna e secilit menaxher të ardhshëm. Ndjekja e kësaj lënde ka për qëllim që studentët të përfitojnë njohuri themelore nga fusha e funksioneve bazike në menaxhment si planifikimi, organizimi, koordinimi, motivi dhe kontrolli. Të mësuarit e kësaj lënde studentëve do t'u mundësojë: - T'i mësojnë bazat e menaxhmentit dhe të aftësohen për to që të japin shembuj konkretë. - Të aftësohen ta shohin këtë lëndë si nevojë për fitimin e njohurive, të cilat do të jenë në kontekst të zbatimit në praktikë të asaj që kanë mësuar. - Të mendojnë në mënyrë efikase që do t'u ndihmojë të përballen me problemet afariste në jetën e tyre të mëtutjeshme.

- **Komunikimi afarist**

Qëllimi i kësaj lënde është që t'i njoftojë studentët me konceptet e komunikimit të biznesit. Përmbajtja e programit është si në vijim: në vitet e fundit gjithnjë e më shumë kompani i përdorin teknikat e komunikimit të biznesit si një mjet kyç për t'u përgjigjur konkurrencës gjithnjë e më të ashpër në tregun global. Kjo lëndë është një përpjekje për t'i përmirësuar aftësitë e komunikimit të studentëve me tregues teorikë dhe para së gjithash me demonstrime praktike të mënyrës së drejtë të komunikimit në një mjedis organizativ me të punësuarit dhe menaxherët, si dhe mbajtjes së takimeve, intervistimin, se si të përgjigjen gjatë intervistës, negocimi dhe motivimi i të gjithëve në rrethin tyre.

- **Menaxhimi i projekteve**

Qëllimi lëndës është që të inkuadrohen studentët në botën e projekteve moderne dhe t'i ballafaqojë ata me mundësitë dhe me sfidat e jetës reale ekonomike në krijimin e projekteve të përshtatshme për nevojat reale. Qëllimet specifike të lëndës janë: si të përcaktohet një projekt i caktuar (duke përdorur disa faza) dhe të theksohet roli i rëndësishëm i menaxherit të projektit (të kuptohen nevoja, fusha e veprimit, aktivitetet për implementim, kompleksiteti i dizajnit modern, etj.). Studentët duhet të trajnohen se si të aplikojnë mjete dhe teknika moderne të menaxhmentit modern të projektimit me rastin e transformimit të nevojës, ose të idesë krijuese në një projekt real e të dokumentuar, i cili do të bëjë të jenë më inventivë për vete dhe më kompetitivë në tregun më konkurrues të punës.

- **Plani i biznesit**

Qëllimi i lëndës është që t'u ndihmojë studentëve për të kuptuar sjelljen e vetëdijshme të ndërmarrjes në kushtet bashkëkohore të afarizmit.

- **Etika dhe përgjegjësia shoqërore e korporatave**

Qëllimi i lëndës është që të zhvillojë njohuri të përgjithshme teorike të përgjegjësisë korporative sociale në ekonominë moderne dhe të analizojë reflektimin e përgjegjësisë korporative sociale në funksionimin e përgjithshëm të ndërmarrjes.

- **Gjuhë frënge 1-2-3**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët t'i forcojnë bazat dhe aftësitë gjuhësore, si dhe t'i zhvillojnë katër kompetencat e komunikimit, veçanërisht në fushat e mëposhtme: të jenë në gjendje të shprehin një mendim, • të jenë në gjendje t'i shprehin ndjenjat, • ta kuptojnë thelbin e një shprehjeje, mendimi apo ideje, • të jenë të aftë të argumentojnë dhe mbrojnë mendimin e tyre. • të gjinden në situata të ndryshme, • të mbajnë një fjalim të thjeshtë dhe koherent, • të rrëfejnë një ngjarje, • të rrëfejnë një ëndërr ose përvojë, • të paraqesin arsyet për një projekt ose ide, • të komunikojnë në mënyrë spontane.

- **Gjuhë italiane 1-2-3**

Qëllimi i mësimdhënies është që studentët të njihen me kulturën italiane, civilizimin Italian dhe gjuhën italiane. Ideja

është që studentët të njohin një realitet tjetër, i cili do t'u ndihmojë në formimin e një ego të vetes, po ashtu edhe në krijimin e një fotografie për veten dhe të ardhmen e tyre. Në përputhje me nivelin (nga A1 deri B2), të cilën studentët do ta zgjedhin, ose nivelet, që do t'i ndjekin në semestrat që i kanë në dispozicion si një lëndë zgjedhore, materia thellohet në mënyrë progresive. Në nivelin e parë fillohet me të dhënat bazike, si p.sh: drejtshkrimi, shqiptimi, terminologjia për menaxhimin me situatat e ndryshme gjuhësore të përditshmërisë (prezantimi i vetes, prezantimi i të tjerëve, orientim në hapësirë dhe kohë, shprehje komunikuese në ndonjë lokal, në restorant, supermarket, në treg), ndërsa arrihet deri në konstruksione më të ndërlikuara në nivelet në vazhdim, që kanë të bëjnë me dhënien e një qëndrimi, dëshire, nevojë, sqarimi të ndodhive të shkuara, të folur të ndodhive të ardhshme, etj. Gramatika prezantohet në mënyrë induktive (nëpërmjet vetëdijesimit nga situatat (audio incizime, video filma, tekste) dhe sjellje të konkluzioneve), në të cilën rolin kryesor e kanë vetë studentët, me pjesëmarrjen e tyre aktive në ligjëratë.

- **Të shkruarit akademik në gjuhën angleze**

Në këtë lëndë do të zhvillohen shkathtësitë akademike të të shkruarit të studentëve në mënyra të ndryshme. Studentët, do të aftësohen t'i komunikojnë idetë e tyre në mënyrë të qartë, të rrjedhshme dhe efektive që të prodhojnë një pjesë të shkruar. Gjithashtu, studentët do të njoftohen me rregullat e citimit dhe parafrazimit dhe do të vetëdijësohen se çka është plagjiatura. Informata kthyesë e një pjesë të shkruar, do të përfshijë vetëkorrigjimin, korrigjimin e njëri-tjetrit dhe korrigjimin nga ana e mësimitdhënësit të përmbajtjes, organizimit dhe gabimeve gjuhësore gjatë procesit të të shkruarit.

- **Arsimim online dhe digjital**

Lënda Arsimit Online dhe Digjital, është lëndë një-semestrale me 3 orë në javë, e cila ofrohet në studimet deridiplomike. Lënda është e përpiluar në bazë të nevojave të studentëve dhe në vete ngërthen shkathtësi të ndryshme të shekullit 21, të cilat janë të lidhura me përdorimin efektiv të teknologjisë. Lënda përmban tri kategori të shkathtësive të shek 21. Pas mbarimit të lëndës, studentët do të jenë në gjendje të kërkojnë dhe të kenë qasje në informatat online, duke përdorur vegla të ndryshme digjitale, të vlerësojnë në mënyrë kritike vërtetësinë e materialeve online dhe të bëjnë dallim mes burimeve të vërteta dhe të rrejshme, të tregojnë mirëkuptim për problemet etike në kontekstin akademik, të kuptojnë si përdoren citatet në mënyrë të drejtë, të mësojnë si kryhet komunikimi profesional në mënyrë efikase, t'i kuptojnë gjërat bazike të sigurisë në internet, si dhe aspektet pozitive dhe negative të krijimit të identitetit online, ta hetojnë shqetësimin-sajber dhe t'i identifikojnë zgjedhjet e mundshme për zvogëlimin e online shqetësimeve.

- **Gjuhë angleze për bashkëbisedim**

Gjuhë Angleze për Bashkëbisedim është lëndë një-semestrale e hartuar për folësit e gjuhës angleze të nivelit të mesëm dhe më lartë. Lënda, do të jetë në dispozicion për studentët në të gjitha semestrat. Anglishtja është një gjuhë ndërkombëtare, që e lehtëson komunikimin në kontekste të ndryshme në mbarë botën, duke filluar nga takimet e biznesit dhe transaksionet në bisedat e rastësishme midis miqve dhe ndërveprimeve gjatë udhëtimit. Anglishtja, në bisedë, do të ndërtojë aftësitë e të dëgjuarit dhe të folurit e studenteve, duke ofruar gramatikë, fjalorin, shqiptimin dhe praktikën e rrjedhshmërisë së nevojshme për llojet e zakonshme të ndërveprimeve të folura angleze. Lënda do të mbulojë tema që lidhen me bisedën profesionale, bisedat e rastësishme dhe ndërveprimet e përditshme, duke u siguruar studentëve besimin e bisedave në një kontekst të ndryshëm. Biseda profesionale, do të përfshijë lloje formale dhe të sjellshme të fjalimit të përdorura në kontekste të tilla, si takime pune, ose diskutime me kolegët. Biseda e rastësishme, do të përfshijë praktikën me gjuhën e përdorur gjatë shoqërimit me miqtë, ose familjen dhe situata të tjera joformale dhe do të përfshijë zhargon dhe fjalim joformal. Ndërveprimet e përditshme, do të përfshijnë biseda në dyqane, gjatë udhëtimit dhe duke kërkuar ndihmë. Metodat e të mësuarit, do të fokusohen në praktikë dhe do të përfshijnë aktivitete dëgjimi, dialogë, role , simulime, debate dhe diskutime.

- **Shkathtësi komunikuese në kontekst profesional në anglisht**

Qëllimi i lëndës është të zhvillojë aftësitë e komunikimit që janë thelbësore për funksionimin efektiv në botën profesionale në anglisht. Objektivat e lëndës përqendrohen në një gamë të gjerë mjedisesh dhe çështjesh profesionale. Studentët, do të hulumtojnë procesin e analizës së situatave të ndryshme të komunikimit dhe në përputhje me rrethanat do t'i kuptojnë ato.

- **Beletristike dhe argëtim**

Lënda synon të eksplorojë një sërë tekstesh tërheqëse dhe të njohura letrare (romane, fragmente, lektura dhe tregime të shkurtra), në mënyrë që të kuptohen dhe shijohen karakteristikat e zhanreve të ndryshme të njohura, duke përfshirë trillimet shkencore, letërsinë për të rinj dhe fantastikën. Ndër objektivat e lëndës, mund të përfshihen me sa vijon: të zhvilluarit e vetëbesimit të studentëve, rrjedhshmërisë dhe interesit për të lexuar në anglisht, të lexuarit e llojeve të ndryshme të romaneve dhe dhënies së përgjigjeve të logjikshme dhe të mprehta, me gojë dhe me shkrim, duke krijuar një lidhje midis përvojës personale, njohurive globale dhe/ose burimeve të tjera (leksioneve, teksteve të leximit, filmave) dhe tekstit të caktuar. Për më tepër, qëllimet janë transferimi i aftësive të përparuara të leximit në

klasën e gjuhës së dytë dhe zhvillimi i këtyre aftësive, duke i bërë studentët lexues më të mirë në të dy gjuhët. Shkathtësitë e të lexuarit përfshijnë: përshkrimin, skanimin, parashikimin, të qëlluarit e fjalëve nga konteksti dhe leximin për një kuptim më të hollësishëm.

- **Letërsi angleze dhe filmi**

Qëllimet e lëndës janë, si vijon: - të ndihmuarit e studentëve të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik përmes analizës së filmit; - diskutimi, vlerësimi dhe përpilimi i komenteve kritike; - analiza kritike e teksteve letrare dhe informuese; - diskutimi dhe analiza e punës së studentëve dhe vlerësimi nga kolegët/shokët; - paraqitja e perspektivave të ndryshme, mbështetja e pretendimeve, përdorimi i gjuhës shqisore.

- **Gjuha maqedonase për terminologji juridike dhe të BE**

Qëllimi i lëndës është t'i aftësojë studentët për kompetencë dhe performancë gjuhësore në fushën profesionale (d.m.th. në fushën e të drejtës dhe BE-së). Bëhet fjalë për një koncept të përqendruar te studenti (learner-centered approach), e që thekson zhvillimin e aftësive të komunikimit në fusha specifike, d.m.th. thellimin dhe përfundimin e aftësive për shprehje të përparuar me shkrim dhe me gojë në gjuhën standarde maqedonase. Materiali i synuar përfshin përmbajtje në lidhje me disiplinat profesionale, si dhe dokumente dhe materiale autentike. Vëmendje e veçantë i kushtohet zotërimit të terminologjisë profesionale dhe zbatimit të saj në kontekst të përshtatshëm gjuhësor dhe zhvillimit të aftësive digjitale. Studentët pritet të bëhen më autonomë në mësimin e gjuhës dhe të jenë në gjendje të mendojnë në mënyrë kritike për një larmi temash, si dhe të fitojnë aftësinë për të komunikuar në gjuhën maqedonase në një mjedis shumëgjuhësh dhe multikulturor.

- **Komunikimi në krizë dhe marrëdhëniet me mediat**

Studentët, do të njihen me ligjërimin – komunikim krize, me përcaktimet, karakteristikat dhe elementet e tij dhe do të mund ta dallojnë atë nga llojet e tjera të komunikimeve. Ata, do të zbatojnë aftësitë e komunikimit në menaxhimin e komunikimit në kohë krize për të zgjidhur konfliktet në realitete specifike komunikimi.

- **Komunikimi global dhe ndërkulturor**

Qëllimi i lëndës: Studentët mund: - T'i kuptojnë modelet e komunikimit midis njerëzve; - Ta analizojnë në mënyrë kritike proceset e globalizimit dhe rolin e tyre në komunikimin ndërkulturor; - Të krijojnë një pasqyrë të teorive të komunikimit ndërkulturor dhe global; - Ta zhvillojnë vetëdijen për kompetencat ndërkulturore; - Të fitojnë aftësi përmes të cilave ata do të jenë komunikues efektivë në një kontekst global dhe ndërkulturor.

- **Sistemet ndërkombëtare të komunikimit**

Njohje me sistemet tradicionale dhe ndërkombëtare të komunikimit. Fitimi i njohurive për sistemet e komunikimit, të cilët kanë rëndësi për studimin bashkëkohor të proceseve komunikuese në shoqëri, prej tradicionaleve dhe deri te sistemet moderne të mediave në vende të ndryshme (në veçanti në hapësirën evropiane). Bëhet fjalë për sisteme të komunikimit dhe për modele të zhvilluara në korniza sociologjike, politike, psikologjike dhe të teorive të tjera dhe shqilla vëmendja e të cilave është e përqendruar në proceset komunikuese në shoqërinë globale. Fokusi është në qasjen ndërdisiplinore në hulumtimin e proceseve të ndërlikuara të komunikimit dhe vënies së integritetit në disiplina të ndryshme shkencore.

- **Të shkruarit dhe raportimi medial**

Kjo lëndë ka për qëllim përparimin e aftësive praktike të studentëve për shkrim gazetaresk dhe raportim në mediat e shkruara dhe elektronike. Kjo lëndë do t'u japë studentëve udhëzime praktike për teknikat themelore të shkrimit medial. Studentët, do të aftësohen të shkruajnë për gazetatat, radion dhe televizionin. Po ashtu, studentët, do të fokusohen si t'i mbledhin, si t'i verifikojnë dhe t'i prezantojnë lajmet para opinionit të gjerë.

- **Studime evropiane**

Lënda ka për qëllim t'i njoftojë studentët me institucionet evropiane, politikat dhe rregulloret, kushtet, proceset dhe perspektivat e proceseve integruuese evropiane. Studentët, do të fitojnë njohuri dhe aftësi për integrimin evropian nga aspekti i komunikimit ndërkombëtar dhe do ta zbatojnë në përgatitjen e projekteve evropiane nga aspekti komunikues.

- **Studime amerikane**

Pas përfundimit të lëndës studime amerikane, studentët do të njoftohen me historinë amerikane, kulturën e tyre dhe mënyrën e jetesës. Studentët, po ashtu, do të përfitojnë aftësi komunikuese të shkruara dhe gojore, si dhe aftësi për të menduarit kritik dhe për analizë.

- **Komunikimi strategjik dhe ndryshimi social**

Qëllimi i lëndës: Kjo lëndë siguron njohuri dhe kuptim lidhur me konceptet qendrore, rolet dhe funksionet e

komunikimit strategjik në shoqërinë bashkëkohore, shqyrton një sërë teorish, strategjish dhe taktikash që grupet e ndryshimeve shoqërore mund të përdorin për të komunikuar vlefshmërinë dhe përfitimet e ndryshimeve që kërkojnë dhe përmes kësaj t'i frymëzojnë njerëzit për veprim. Qëllimi është të ndihmojë studentët të promovojnë drejtësinë sociale përmes komunikimit efektiv. Përmes kësaj lënde studentët do të kenë një kuptim të plotë rreth: • Natyrës së problemeve sociale dhe mënyrave në të cilat shkaqet dhe zgjidhjet e tyre lidhen me politikat publike, mediat masive dhe dallimet kulturore. • Rolit unik shoqëror të grupeve të ndryshimit social dhe mënyrave se si nevojat e tyre të komunikimit ndryshojnë nga modelet e bazuara në korporata të përdorura nga biznesi dhe organizatat tradicionale jofitimprurëse. • Një procesi komunikimi strategjik të krijuar për të ndihmuar grupet e ndryshimeve sociale të frymëzojnë veprim. • Teknologjive, mjeteve dhe teknikave të veçanta për zbatimin e strategjisë. Studentët, do t'i arrijnë këto objektiva përmes diskutimit në klasë të leximeve të zgjedhura, hulumtimit dhe analizimit të një problemi, ose problemi aktual social sipas zgjedhjes së tyre, përmes hartimit të një strategjie komunikimi për të ndikuar në çështjen e zgjedhur dhe prezantimit të asaj strategjie në klasë.

- **Komunikimi ndërpersonal**

Qëllimi i programit të lëndës është që studentët të fitojnë njohuri nga teoria dhe praktika e komunikimit ndërpersonal. Studentët, do të hulumtojnë procesin komunikues, do të vlerësojnë të kuptuarit e komunikimeve ndërpersonale dhe marrëdhënieve, do ta vlerësojnë rolin e komunikimit në krijimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve efektive ndërnjerëzore dhe do ta vlerësojnë rolin e komunikimit si qytetarë në shoqëri.

- **Komunikimi ndërkulturor**

Qëllimi i lëndës është që studentët: - Të bëhen të vetëdijshëm për kulturën e tyre, por gjithashtu bëhen të vetëdijshëm për kulturat e tjera dhe dinamikat që shfaqen në procesin e ndërveprimit; - Të kuptojnë se si proceset e komunikimit janë të ndryshme në kultura të ndryshme; - Të njihen me fenomenin e stereotipeve dhe paragjykimëve, si dhe mënyrat e trajtimit të tyre dhe zvogëlimit të tyre; - Ta kuptojnë konceptin e "tjetrit" dhe nevojën për të zhvilluar një ndjenjë empatie me grupet e marginalizuara; - T'i identifikojnë sfidat që dalin si rezultat i dallimeve në ndërveprimin ndërkulturor dhe të mësojë t'i përballojë ato në mënyrë krijuese; - Ta kuptojnë rolin kryesor që luan konteksti dhe mekanizmat e fuqisë në komunikimin ndërkulturor; - Të fitojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime që do të forcojnë kompetencën e tyre ndërkulturore.

- **Komunikimi i biznesit dhe profesional**

Studentët, do të fitojnë aftësi themelore për komunikim profesional dhe të biznesit. Ata do të përgatiten dhe do të bëjnë prezantim informativ të biznesit. Studentët, do të përgatisin dhe bëjnë prezantim për shitje dhe marketing. Studentët do të dinë të përdorin format themelore të biznes korrespondencës. Studentët do të jenë të përgatitur të marrin pjesë në procese të vendimmarrjes në situata të ndryshme të komunikimit dhe në ambiente të ndryshme profesionale dhe të biznesit.

- **Komunikimi dhe edukimi mediatik**

Një demokraci varet nga një qytetar i informuar dhe i artikuluar. Kjo lëndë do të nxjerrë në pah rëndësinë jo vetëm të mesazhit, por edhe të dërguesit. Do t'i ndihmojë studentët të përdorin mediat e komunikimit në mënyrë më efektive dhe të kontrollojnë më mirë ndikimin e mediave mbi veten dhe të tjerët. Edukimi mediatik (shkrim-leximi) promovon aftësitë e të menduarit kritik që i fuqizojnë njerëzit të gjykojnë të pavarur dhe të marrin vendime, të informuar, duke u përgjigjur në bazë të informacionit të përçuar përmes kanaleve të komunikimit masiv. Kjo këndë është krijuar për të ndihmuar studentët që të zhvillojnë një kuptim të informuar, kritik dhe praktik ndaj mediave të reja të komunikimit, përfshirë analizën e mediave digjitale. Do të eksplorojmë qëllimet dhe metodat e industrive të ndryshme të medias, do të identifikojmë efektet që ka media mbi ne, do të kuptojmë përfitimet dhe efektet e mundshme negative të përmbajtjes së medias dhe do të identifikojmë teknikat për t'u bërë më të shkolluar në media si individë dhe shoqëri. Kjo lëndë i ndihmon studentët të zhvillojnë shkathhtësinë e tyre mediatike dhe aftësitë analitike. Temat, siç janë: ndikimi i reklamave në përmbajtje; efektet e mediave në aftësitë tona njohëse; dhe trajtohet rëndësia e njohurive të botës reale. Do të eksplorojmë mesazhet e dërguara nga mediat dhe mënyrën se si ato stisen në vetvete, shpesh në mënyrë delikate dhe madje edhe sublimuara, në botën reale të njerëzve, vendndodhjeve dhe ngjarjeve. Qëllimi është që ta kuptojmë më mirë përmbajtjen e mediave, industritë e mediave dhe mënyrën se si ato ndikojnë tek ne.

- **Teoria bashkëkohore e retorikës**

Qëllimi i lëndës: -duhet të dinë çfarë nënkupton retorika bashkëkohore; -cilat janë konceptet bazike të retorikës; -dallimet mes retorikës klasike dhe retorikës bashkëkohore; -të dinë të krijojnë një diskutim solid

- **Ligji dhe etika në gazetari dhe media masive**

Qëllimi i lëndës: Zhvillimi dhe përmirësimi i njohurive dhe botëkuptimeve teoriko-shkencore dhe zhvillimi i aftësive

akademike në fushën e së drejtës së medias, si dhe zotërimi i njohurive dhe aftësive të nevojshme për zgjidhjen e problemeve praktike në fushën e të drejtës për mediat. Përvetësimi i njohurive bazë dhe të thelluara të së drejtës së medias në botë dhe në RMV. Trajnim për interpretimin dhe aplikimin e dispozitave në fushën e të drejtës për mediat, lirisë së medias, të drejtës së transmetimit dhe të drejtës së internetit.